DEKRET
Nr.1796, datë 16.5.1997

PËR SHPËRNDARJEN E KUVENDIT POPULLOR DHE CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME TË KUVENDIT POPULLOR

Në mbështetje të nenit 28, pika 3 dhe 9 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe në deklaratën e Kuvendit Popullor, datë 13.5.1997, për vetëshpërndarjen e tij,

DEKRETOJ:

Neni 1

Kuvendi Popullor shpërndahet përpara mbarimit të afatit të legjislaturës.

Neni 2

Zgjedhjet e reja për deputetët e Kuvendit Popullor të bëhen ditën e diel, datë 29 qershor 1997.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha